

## PROGRAMI I PRAKTIKËS PROFESIONALE PËR CIKIN E PARË TË STUDIMEVE (Bachelor)

Të nderuar studentë!

Ju do të kryeni praktikën profesionale e cila do të zgjasë \_\_\_\_\_ në përputhje me programin e studimeve të miratuar.

Ju duhet të **aplikoni individualisht për të siguruar vendet e kryerjes së praktikës profesionale** të cilat mund të jenë: Ndërmarrje Agrobiznesi (inpute, prodhimi dhe autpute), Ferma të mëdha (serra, komplekse blegtorale, plantacione vreshtash ose drufrutorësh etj), Banka te nivelit të dytë, organe në sistemin Tatim-Taksa, Sistemi Doganor, organe të qeverisjes qëndrore dhe lokale (Bashki, Komuna), etj.

Mbeshtetur ne programet e lendeve qe ju keni zhvilluar si dhe në vartësi të vëndit ku do të kryhet ajo, Ju duhet të sillni **një raport** me shkrim të strukturur në dy pjese.

Pjesa e parë duhet të përmbajë sa më poshtë:

1. Formën e organizimit të ndërmarrjes (SH.P.K, Shoqëri Anonime, etj)
2. Formën e organizimit të brendshëm dhe mënyrën e funksionimit të saj, statutin e shoqërisë, veçanërisht me ato "filial dhe mëmë" që kanë lidhje me kapitalin e themelimit, menyrën e organizimit dhe të funksionimit, kriteret e llogaritjes dhe shpërndarjes së fitim/humbjeve, krijimi i rezervave dhe fondeve të ndryshme.
3. Strukturën organizative të firmes, vendin që zëne Departamentet e ndryshme në të, nivelin e integritimit vertikal, etj.
4. Një përshkrim të shkurtër të **detyrave kryesore të realizuara nga ju** në Ndërmarrje si dhe dokumentacionin më kryesor të njohur dhe përdorur nga ju gjatë kohës së kryerjes së praktikës.

Pjesa e dytë duhet të trajtojë problematikën e mëposhtme (Varësisht profilit të subjektit ku do të kryhet praktika):

A- Njohuritë kryesore të aftësisë tuaj praktik në lidhje me **Drejtimin dhe Marketingun**, që hasin kryesisht ndërmarrjet e agrobiznesit si:

- Njohja dhe përshkrimi i formës së organizimit të ndërmarrjes, avantazhet dhe dobësitë e saj;
- Vlerësimi i nivelit të integritimit vertikal të saj;
- Për produktet që realizon ndërmarrja të bëhet analiza e pikës kufi.
- Përshkrimi i ambientit të MKTG dhe drejtimit, analiza SWOT.
- Njohja me planin e marketingut dhe te prodhimit;
- Vlerësimi i gjendjes aktuale të MKTG lidhur me 4 aspektet e tij: Produkti, Shpërndarja, Promocioni dhe Çmimet;
- Analiza e aspekteve sociale që lidhen me MKTG.
- Analizë të funksioneve bazë menaxheriale si edhe rolit të organizatës në rastin e institucioneve publike ose organizatat e pavarura.
- Sfida të zhvillimit strategjik të të gjitha llojeve të ndërmarrjeve në sektorin publik dhe atë privat.

**B-** Studenti do të njihet dhe do të raportojë për çështjet e **analizës financiare** duke siguruar për çdo dokument apo libër kontabël një kopje të tij, si më poshtë:

1. Njohja me dokumentacionin kryesor-bazë për analizën e gjendjes ekonomike financiare të ndërmarrjes, si Bilanci kontabël, Llogaria e fitimeve dhe humbjeve të ushtrimit, etj.
2. Studimi i lidhjeve kryesore të grupeve të bilancit, struktura e aktivitetit dhe pasivitetit, llogaritja e aftësisë paguese, pavarësisë financiare, të kapitalit qarkullues neto, të treguesve të likuiditetit, të qëndrueshmërisë dhe elasticitetit, etj.
3. Llogaritja me të dhëna konkrete të treguesit të rentabilitetit të kapitalit gjithsej të investuar, të kapitalit vetë dhe të huajtur. Përcaktimi i faktorëve përkatës dhe interpretimi i gjendjes.
4. Studimi nëpërmjet treguesve të llogarisë fitime dhe humbje.
5. Grumbullimi i të dhënave të nevojshme për analizën e elementëve kryesore të kostos së prodhimit dhe i të ardhurave nga shitja.
6. Analiza nëpërmjet treguesve të elementëve të kapitalit qarkullues, llogaritja e përdorimit me efektivitetit të këtyre elementëve.
7. Analiza e debi - kredive të ndërmarrjes nëpërmjet treguesve.

**C-** Përsa i takon fushës së **Institucioneve Financiare**, studenti do të njihet, do të ndjekë dhe analizojë si më poshtë:

1. Njohja me dokumentacionin dhe operacionet bankare. Këtu përfshihen si dokumentacioni kontabël ashtu edhe dokumentacioni analizues (bilanci kontabël dhe pasqyrat e analizës) si edhe operacionet bazë të njësive bankare.
2. Njohja dhe plotësimi i instrumentave të pagesës. Këtu përfshihen llojet e ndryshme të çeqeve, urdhërkalimi, letrat e kreditit, karta e kreditit dhe e debitit etj.
3. Njohja me operacionet e shërbimit në sportel të bankës. Lëvizjen e parave (Cash-i), dhe shërbimi në sportel.
4. Njohja me praktiken e kreditimit dhe investimit të institucioneve financiare.
5. Analiza e një rasti studimi të praktikave të kredisë të një firme agrobiznesi që është e mundur të bëhet duke analizuar dosjen e një kredimarrësi të kësaj fushe.

**DEPARTAMENTI I DREJTIMIT TË AGROBIZNESIT**